REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPSTINA KLINA
Nr.No.Br. 650-11269/25
Data-Date-Datum 26.06.2025
Klinë-Klina

RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

Qershor, 2025

HYRJE

Korniza afatmesme buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2026-2028 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentet strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës.

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili përgatitet nga administrata komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivave prioritet, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, nëpërmjet integrimit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Korniza afatmesme buxhetore komunale bazohet në parashikimet e mundshme reale të hyrave të planifikuara për periudhën afatmesme buxhetore: garantëve qeveritare në formë të kufijve buxhetor, parashikimet mbi trendin e të hyrave vetanake si dhe parashikimeve mbi donacionet e mundshme qoftë edhe në formë participimeve të qytetarëve (grave dhe burrave) si dhe parashikimet reale të shpenzimeve buxhetore nëpër programet komunale që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2026/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëv në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). KAB 2026-2028 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2026.

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Klinës, Nr. 01-110-1232/2010, të datës 07.04.2010, si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Komuna, komuna e Klinës ka organizuar dëgjimet buxhetore.

Grupi punues ka mbledhur komentet dhe në takimet e mbajtura me datat; Salla e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave, datë 05.06.2025, në SHFMU "Isa Boletini", në fshatin Poterç i Epërm, datë 05.06.2025, në SHFMU "Azem Bejta", në fshatin Grabanicë, datë 05.06.2025, në SHFMU "Motrat Qiriazi", në fshatin Zajm, datë 09.06.2025, në SHFMU "Avni Zhabota", në fshatin Shtupel, më komunitetin joshumicë, datë 09.06.2025, në SHFMU "Tre Dëshmorët", në fshatin Jashanicë, datë 10.06.2025, në SHFMU "Dëshmorët e Qëndresës", në fshatin Gllarevë, datë 10.06.2025, në SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi", në fshatin Zllakuqan, datë 11.06.2025, në Shtëpia e Kulturës "Jehona e Dukagjinit", me temë "Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës, datë 11.06.2025, në Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm, datë 12.06.2025, si dhe riorganizimin e dëgjimit buxhetorë të XI-të më radhë,

më temën "Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës", datë 20.06.2025, ku më pas ka diskutuar kërkesat e qytetarëve dhe ka vendosur për pranimin refuzimin a po adresimin e tyre.

Vlerësimi i kërkesave të qytetarëve është bërë duke pasur parasysh ndikimin e kërkesës në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028, ndikimin e kërkesës në komunitetin e gjerë dhe afërsisë së kërkesës me prioritetet e komunës për zonën. Grupi punues ka trajtuar edhe implikimet buxhetore të kërkesave dhe ndikimin e tyre në linjtë buxhetore.

Sipas standardeve të UA nr. 04/2023 grupi punues me shumicë votash ka vendosur sipas arsyetimeve që janë në këtë raport. Mbi kriteret e paracaktuara grupi punues ka vendosur të pranoj, refuzoj apo adresoj kërkesat që janë pranuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore. Sipas kritereve të paracaktuara kërkesat janë trajtuar si vijon:

Pranuar: Kërkesa të cilat grupi punues i ka vlerësuar nevojë për qytetarët dhe ka rekomanduar të futen në buxhetin e komunës,

Pranuar pjesërisht: kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se ka nevojë dhe mund të përmbushen pjesërisht nga buxheti i komunës,

Refuzuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të përmbushen nga buxheti i komunës dhe janë jashtë mandatit,

Adresuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të adresohen nëpërmjet buxhetit për shkak se kërkesat adresohen nga institucionet e tjera apo mekanizmat administrativ të komunës dhe institucioneve të tjera.

Raporti përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor dhe është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare. Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe WORD dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Të gjithë emrat dhe fotografitë e qytetarëve që janë përdorur gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë me pëlqimin e tyre. Grupi punues ka vendosur që të redaktoj dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky raport në ditën e miratimit është bërë publik dhe i është dorëzuar Kryetarit të Komunës dhe Asamblesë së Komunës së Klinës, si pikë e veçantë për shqyrtim, para miratimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2026.

Në faqen e komunës në kuadër të këtij procesi janë publikuar; Plani i Brendshëm i Punës i Grupit Punues për Organizimin e Dëgjimeve Buxhetore, Kalendari i Dëgjimeve, Plani i Punës për Organizimin e Dëgjimeve Buxhetore, ftesat për pjesëmarrje, raportet e shkurta nga

dëgjimet, procesverbalet nga dëgjimet dhe materialet e tjera provuese të cilat janë të listuar në fund të këtij dokumenti si anekse.

Sipas planit të punës komuna ka organizuar dhjetë dëgjime buxhetore dhe njëmbëdhjetë me takimin e Kuvendit Komunal, në të cilat kanë marrë pjesë **255** qytetarë fizikisht nëpër dëgjime, prej të cilëve **67 Gra** dhe **188 Burra.**

Grupi punues ka listuar **136 kërkesa**, prej të cilave, **122 janë pranuar**, **6 janë refuzuar** dhe **8 janë adresuar.**

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuara apo të refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, është finalizuar dhe është proceduar, në Kuvendin e Komunës së Klinës.

SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE AFAT-MESËM 2026-2028

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkorës Buxhetore komunale 2026/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në Strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2026, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Klinës prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore, pjesë e cila është elaboruar më së shumti gjatë dëgjimeve buxhetore:

Shtojca nr 1. Korniza Buxhetore Komunale, në euro:

	Përshkrimi	2025	2026 (planifikim)	2027 (vlerësimet)	2028 (vlerësimet)
1	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	16,168,653.00	16,338,898.00	17,130,331.00	17,939,537.00
1	Të hyrat vetanake	1,495,504.00	1,551,784.00	1,662,711.00	1,669,206.00
1	Grantet dhe transferet qeveritare	14,673,149.00	14,787,114.00	15,467,620.00	16,270,331.00
2	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	16,168,653.00	16,338,898.00	17,130,331.00	17,939,537.00

2.1	**Shpenzimet rrjedhëse**	**11,762,032.00**	**12,238,898.00**	**12,630,331.00**	**13,139,537.00**
	Pagat dhe meditjet	8,892,032.00	9,468,898.00	9,709,772.00	9,839,537.00
	Mallrat dhe shërbim	1,700,000.00	1,600,000.00	1,720,559.00	1,800,000.00
	Shërbime komunale	370,000.00	370,000.00	400,000.00	550,000.00
	Subvencionet	800,000.00	800,000.00	800,000.00	950,000.00
2	**Shpenzimet Kapitale**	**4,406,621.00**	**4,100,000.00**	**4,500,000.00**	**4,800,000.00**

Si pjesë e dytë që është elaboruar më së shumti gjatë dëgjimeve më interes dhe kërkesë të qytetarëve ishin edhe Investimet Kapitale. Investimet Kapitale janë prezantuar në detaje, më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit gjithëpërfshirës, për Komunën e Klinës. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Klinës në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhë afatgjatë.

PROJEKTET ME PRIORITET PËR VITIN 2026

Nr.	Emri i projektit	Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente te tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, Sh.Sadiku, H.Krasniqi, S.Rama, A.Rexha etj	80,000.00	60,000.00	20,000.00
2	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	60,000.00	30,000.00	30,000.00
3	Bashkëfinancim me donatorë	1,150,000.00	650,000.00	500,000.00
4	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	40,000.00	20,000.00	20,000.00
5	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Malë Bashota, Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu, Shaban Sadiku, Heronjtë e Kombit dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	350,000.00	250,000.00	100,000.00
6	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	100,000.00	70,000.00	30,000.00
7	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovc	60,000.00	50,000.00	10,000.00
8	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)	60,000.00	40,000.00	20,000.00
9	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe rindërtimi i rrugës Klinë-Shtupel-Kërnicë	50,000.00	30,000.00	20,000.00
10	Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grapc	40,000.00	20,000.00	20,000.00

11	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupevë-Dush	80,000.00	50,000.00	30,000.00
12	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Cerovik-Qabiq-Dobërdol	50,000.00	35,000.00	15,000.00
13	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	20,000.00	20,000.00	
14	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqeve-Ujmire-Shtarice	40,000.00	20,000.00	20,000.00
15	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudice	20,000.00	10,000.00	10,000.00
16	Ndërtimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokësore Gllareve-Rixheve-Stapanice-Zabergje	100,000.00	55,000.00	45,000.00
17	Ndërtimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	30,000.00	30,000.00	-
18	Ndërtimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokësore ne Grabanice-Bokshiq-Dollove	60,000.00	40,000.00	20,000.00
19	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë - Dush	30,000.00	30,000.00	
20	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bradhë	50,000.00	50,000.00	
21	Ndërtimi i shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarines-Pogragjë	10,000.00		10,000.00
22	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	70,000.00	50,000.00	20,000.00
23	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta-Përqevë"	130,000.00	100,000.00	30,000.00
24	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	35,000.00	35,000.00	
25	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	35,000.00	25,000.00	10,000.00
26	Ndërtimi i rrugës "Bedri Mustafa"	50,000.00	30,000.00	20,000.00
27	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha"	50,000.00	30,000.00	20,000.00
28	Ndërtimi i rrugës "Vëllezrit Gërvalla"	30,000.00	10,000.00	20,000.00
29	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	10,000.00		10,000.00
30	Rindërtimi i sheshit të Qytetit të Klinës	50,000.00		50,000.00
31	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	10,000.00		10,000.00
32	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	10,000.00		10,000.00
	Urbanizmi	**2,960,000.00**	**1,840,000.00**	**1,120,000.00**
33	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj	70,000.00	40,000.00	30,000.00
34	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj	185,000.00	135,000.00	50,000.00
35	Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videjë etj	170,000.00	130,000.00	40,000.00

36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj	90,000.00	60,000.00	30,000.00
37	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel etj	130,000.00	100,000.00	30,000.00
	Infrastruktura rrugore	**645,000.00**	**465,000.00**	**180,000.00**
38	Furnizim me tabela te menqura ne shkolle në Çabiq, Ujmirë, Ismet Rraci, Motrat Qiriazi, Fehmi Agani, Luigj Gurakuqi etj	30,000.00	30,000.00	-
39	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet në shkolla në Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik i Madh, Budisalc, Ujmirë, Drenoc, Volljak, Grabanicë, Jagodë, Shtupel etj	90,000.00	60,000.00	30,000.00
40	Ndriqimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriazi, Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	0.00		-
41	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	60,000.00	40,000.00	20,000.00
	Arsimi	**180,000.00**	**130,000.00**	**50,000.00**
42	Furnizim me paisje mejksore per diagnostike	40,000.00	40,000.00	-
43	Ndertimi dhe rindertimi i objekteve shendetesore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj	30,000.00	20,000.00	10,000.00
	Shendetësia	**70,000.00**	**60,000.00**	**10,000.00**
44	Ndertimi i shtepise se pleqeve ne Kline	20,000.00		20,000.00
	Sherbimet Rezidenciale	**20,000.00**	**-**	**20,000.00**
45	Ndertimi dhe rindertimi i Objektit Komunal ne Kline	20,000.00	20,000.00	-
46	Blerja e veturave zyrtare per nevoja te Administrates Komunale	35,000.00		35,000.00
	Administrata	**55,000.00**	**20,000.00**	**35,000.00**
47	Ndertimi dhe Rindertimi i Objekteve Sportive te Kultures ne Kline	40,000.00	25,000.00	15,000.00
	Kultura	**40,000.00**	**25,000.00**	**15,000.00**
48	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike	0.00		
	Gjeodezia	-	-	-
49	Ndërtimi i kanaleve te ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	130,000.00	70,000.00	60,000.00
	Bujqesia	**130,000.00**	**70,000.00**	**60,000.00**
	Totali :	**4,100,000.00**	**2,610,000.00**	**1,490,000.00**

Ndërsa lista e projekteve me prioritet për vitet 2027 dhe 2028 janë të paraqitura në Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore të publikuar në web faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

ANALIZA GJINORE / BUXHETIMI GJINOR

Gjithashtu rëndësi e veçant i është kushtuar si në hartim të kornizës ashtu edhe në dëgjime buxhetore është edhe analizën gjinore. Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, dhe paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Kategoria	**Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024**	**%**
Meshkuj	15029	49.27
Femra	15474	50.73
Popullata e përgjithshme	30503	100

Komuna i ka përdorur më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor të projekteve kapitale në kuadër të buxhetit të 2026-2028. Për shembull, kur një projekt është për qytet apo për një fshat, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, për qendër shëndetësore etj. ne kemi përdorur të dhënat e ndarjes së popullsisë në mes meshkujve dhe femrave për atë zonë. Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne kemi përdorur numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra. Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) në përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2024.

ECURIA E DËGJIMEVE BUXHETORE PËR DRAFT-KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026 - 2028

Bazuar në Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Komuna e Klinës ka bërë një planifikim të hershëm të procesit të konsultimeve publike, si dhe procesin buxhetor më dëgjimeve buxhetore, siç e përcakton edhen neni 20, Planifikimi i konsultimeve publike, sipas pikave;

1. Planifikimi i përgjithshëm i konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik, si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim me publikun,

2. Zyrtari përgjegjës për konsultim publik koordinim me iniciuesit harton plan të veçantë, për të gjitha project propozimet e organit propozues të akteve nënligjore dhe politikave lokale, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik për vitin e ardhshëm kalendarik,

3. Plani i konsultimeve publike duhet të jetë pjesë përbërëse e planit për komunikim me publikun dhe duhet të publikohet,

4. Planifikimi i konsultimit merr për bazë afatet kohore, kostot financiare, resurset njerëzore, indentifikimin e palëve të përfshira në procesin e konsultimit publik, si dhe format dhe teknikat e konsultimit publik.

Komuna e Klinës, përkatësisht ekzekutivi komunal ka hartuar Planifikim e Konsultimeve Publike për vitin 2025, më ç'rast pjesë e këtij planifikimi janë edhe dëgjimet buxhetore. Linku i publikimit të këtij plani në web faqen zyrtare;

https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/PLANI-I-KONSULTIMEVE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-VITIN-2025.pdf

Hapi i dytë më radhë për planifikim të hershëm buxhetor, sipas UA (MAPL) Nr.04/2023, neni 31, Dëgjimet buxhetore, pika 3. i cili parasheh që në procesin e planifikimit buxhetor kryetari i komunës themelon një grup punues i cili është ekipi përgjegjës për hartimin e projekt propozimit dhe përgatitjen si dhe realizimin e dëgjimeve buxhetore. Grupi punues udhëhiqet nga drejtoria përkatëse e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik. Organi propozues siguron zbatimin e standardeve minimale të procesit të konsultimit, andaj edhe kryetari i Komunës së Klinës, ka themeluar grupin punues si hapin tjetër vijues të këtij procesi, më datën 27 shkurt 2025, më numër protokolli 01 Nr. 112-5926/2025, të udhëhequr nga drejtori e Financave, në këtë përbërje;

1. Enver Berisha, Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
2. Enver Berisha, Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik,
3. Melihate Behramaj, Zyrtarja Kryesore Financiare,
4. Vlora Tafili, Zyrtare përgjegjëse për Konsultim Publik,
5. Nikson Daka, drejtor i Kadastrit dhe Gjeodezisë,
6. Mirsad Dakaj, Këshilltarë i Kryetarit për Media,
7. Viktor Kuqi, Asistent administrative i kryetarit.

Më kërkesë të Zyrtares Kryesore Financiar, grupi punues është plotësuar (vendimi bazë), edhe me dy zyrtare shtesë të cilat implikohen direkt në hartimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe Buxhetit;

1. Arbëresha Tanushi, Zyrtare e lart për Buxhet dhe Financa,
2. Njomëza Jaha, Analiste e lart e Buxhetit,

Neni 30, pika 4, i UA (MAPL) Nr.04/2023, ky grup është i obliguar të planifikojnë kalendarin e dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e komunës dhe KAB-in, dhe të organizojnë dëgjime buxhetore të përcaktuar sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësive .

Shtojca nr. 2 – Linqet e vendimeve të kryetarit të publikuara në web faqen zyrtare;

Linku i vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 si dhe organizimin e dëgjimeve buxhetore;

https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Vendim-i-grupit-punues-per-hartimin-e-draft-KAB-2026-2028.pdf

Linku i vendimit për plotësimin e vendimit për grupin punues për hartimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 si dhe organizimin e dëgjimeve buxhetore;

https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Scan013-1.pdf

Lidhur me përfshirjen e palëve të interesuara (çdo person fizik dhe juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit, si dhe subjekte të tjera që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes), në grupet punuese përgjegjëse për hartimin e projekt propozimeve, grupi punues ka angazhuar si trupa ndihmëse edhe;

1. Qendrën e Angazhimit në Komunitet (QAK), koordinatoren, znj.Vitore Zefi, (Qendra e Angazhimit në Komunitet (QAK) është një strukturë e krijuar për të nxitur dhe forcuar pjesëmarrjen qytetare dhe bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe komunitetit lokal. Këto qendra zakonisht funksionojnë si hapësira fizike ose platforma ndërveprimi, ku qytetarët mund të japin kontributin e tyre në proceset vendimmarrëse, veçanërisht në fusha si buxhetimi, planifikimi i politikave lokale dhe mbështetja për grupet vulnerabël.)

1. Zyrtaren për Barazi Gjinore, znj. Vitore Shala,
2. Përfaqësuesin nga Zyra për Kthim dhe Komunitete, z. Halil Kerellaj,
3. Zyrtarin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut si dhe Koordinatorin për Përformancë Komunale, z. Drilon Morina,
4. Komitetin për Politikë dhe Financa, anëtarin/përfaqësuesin Tunë Dedaj,
5. Kryetarë e Këshillave Lokal.

Grupi punues ka qenë përgjegjës për hartimin e Draft-Buxhetin e vitit 2025, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga dëgjimet buxhetore dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre si dhe hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera që dalin nga Udhëzimi Administrativ të MAPL-ës nr. 04/2023. Pas marrjes së vendimit, grupi punues ka hartuar planin e të organizimit të debateve me publikun:

Shtojca nr. 3 – Tabela e detajuar e kalendarit të organizimit të dëgjimeve buxhetore për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028;

Nr.	Planifikimi i dëgjimeve buxhetore	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Data/dita e mbajtjes së dëgjimit	Koha/ora
1.	TAKIMI I - Salla e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.	Komuna Klinë, Salla e Konferencave.	05.06.2025	10:00
2.	TAKIMI II - SHFMU "Isa Boletini", në fshatin Poterç i Epërm, më banorët e fshatrave Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, Drenoc dhe Dugajevë.	SHFMU "Isa Boletini", në fshatin Poterç i Epërm.	05.06.2025	17:00
3.	TAKIMI III - SHFMU "Azem Bejta", në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.	SHFMU "Azem Bejta", në fshatin Grabanicë.	05.06.2025	18:30
4.	TAKIMI IV - SHFMU "Motrat Qiriazi", në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dollc dhe Dresnik.	SHFMU "Motrat Qiriazi", në fshatin Zajm.	09.06.2025	17:00
5.	TAKIMI V - SHFMU "Avni Zhabota", në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë).	SHFMU "Avni Zhabota", në fshatin Shtupel.	09.06.2025	18:30
6.	TAKIMI VI - SHFMU "Tre Dëshmorët", në fshatin Jashanicë, me banorët e fshatrave Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Ujmirë, Doberdol.	SHFMU "Tre Dëshmorët", në fshatin Jashanicë.	10.06.2025	17:00
7.	TAKIMI VII – SHFMU "Dëshmorët e Qëndresës", në fshatin Gllarevë, me banorët e fshatrave Gllarevë, Sferkë, Caravik, Volljakë, Zabergjë, Përçevë.	SHFMU "Dëshmorët e Qëndresës", në fshatin Gllarevë.	10.06.2025	18:30
8.	TAKIMI VIII - SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi", në fshatin Zllakuqan, më banorët e fshatrave Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë e Madhe dhe Budisalc.	SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi", në fshatin Zllakuqan.	11.06.2025	17:00

9.	TAKIMI IX – Shtëpia e Kulturës "Jehona e Dukagjinit", me temë "Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës.	Shtëpia e Kulturës "Jehona e Dukagjinit", në Klinë, sheshi "Mujë Krasniqi".	11.06.2025	16:00
10.	TAKIMI X - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve.	Salla e Kuvendit Komunal Klinë, në Klinë.	12.06.2025	10:00

Takimi i datës **11.06.2025,** i cili ka qenë i planifikuar të mbahet në Shtëpia e Kulturës "Jehona e Dukagjinit", **me temë "Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës**, për shkak të pjesëmarrjes së ulët në takimin e parë, ka riorganizojë një takim të dytë me këtë grup të rëndësishëm të komunitetit. Takimi është mbajtur më 20 qershor 2025, duke filluar nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit Komunal Klinë. Ky riorganizohet i takimit në kuadër të takimeve me qytetarë për Hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), vjen si nevojë për të siguruar një përfaqësim më të gjerë dhe për të dëgjuar zërin dhe nevojat e grave dhe të rinjve në procesin e planifikimit buxhetor për tri vitet e ardhshme.

Sfidë: Një ndër sfidat kryesore me të cilat përballet Komuna e Klinës është përfshirja e ulët e grave në dëgjimet buxhetore. Kjo mospjesëmarrje jo vetëm që cenon përfaqësimin e barabartë gjinor, por ndikon edhe në hartimin e buxheteve që nuk pasqyrojnë në mënyrë të drejtë nevojat dhe prioritetet e grave në komunitet.

Para datës së takimeve, grupi punues ka nxjerrë në radion lokale "Radio Alba", portalin lokal "Klina Info", rrjetet sociale të komunës si dhe ka vendosur njoftimet fizike për të gjitha institucionet komunale, qytetarët, OJQ-të, organizatat e biznesit, kryetarët e fshatrave të bashkësive lokale, media dhe të interesuarit tjerë për pjesëmarrje në këtë takim, si dhe pjesëmarrjen me kërkesa dhe sugjerime në mënyrë elektronike te zyrtarët:

1. Vlora Tafili, email: vlora.tafili@rks-gov.net;
2. Melihate Behramaj, email: Melihate.behramaj@rks-gov.net.

Gjithashtu dhe mundësinë e dorëzimit të propozimeve lidhur me këto akte me shkrim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, kati II dhe Zyrën e Drejtorisë së Financave, kati I, zyra e dytë, ana e djathtë. Propozimet dhe sugjerimet e të gjithë interesuarve janë mirëpritur **nga data 28.05.2025**, gjatë mbajtjes së dëgjimeve dhe **deri me datën 24.06.2025.**

Përveç takimeve me publikun nëpër lokalitete dhe në sallën e Kuvendit Komunal, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët prej 30 ditësh në ueb-faqen zyrtare të komunës, ndërsa nuk ka qenë e mundur të realizohet konsultimi publik në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë, për shkak të problemeve teknike;



Shtojca nr. 4 – Tabela e detajuar e metodologjisë së dëgjimeve:

Metodat e dëgjimeve	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Ndarja sipas gjinisë	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Dëgjim Buxhetor në Sallën e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.	05.06.2025	**20** Pjesëmarrës.	**20** Burra, **0** Gra.	**67** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **62** Pranohen, **2** Refuzohet, **3** Adresohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU "Isa Boletini", në fshatin Poterç i Epërm, më banorët e fshatrave Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, Drenoc dhe Dugajevë.	05.06.2025	**25** Pjesëmarrës.	**25** Burra, **0** Gra.	**3** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **3** Pranohen, **0** Refuzimc.

Dëgjim Buxhetor në SHFMU "Azem Bejta", në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.	05.06.2025	**8** Pjesëmarrës.	**8** Burra, **0** Gra.	**8** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **8** Pranohen, **0** Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU "Motrat Qiriazi", në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dollc dhe Dresnik.	09.06.2025	**37** Pjesëmarrës.	**37** Burra, **0** Gra.	**4** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **3** Pranohen, **1** Refuzohet.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU "Avni Zhabota", në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë).	09.06.2025	**16** Pjesëmarrës.	**15** Burra, **1** Grua.	**6** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **6** Pranohen, **0** Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU "Tre Dëshmorët", në fshatin Jashanicë, me banorët e fshatrave Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Ujmirë, Doberdol.	10.06.2025	**14** Pjesëmarrës.	**14** Burra, **0** Grua.	**2** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **2** Pranohen, **0** Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU "Dëshmorët e Qëndresës", në fshatin Gllarevë, me banorët e fshatrave Gllarevë,	10.06.2025	**12** Pjesëmarrës.	**12** Burra, **0** Grua.	**9** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **5** Pranohen,

Sferkë, Caravik, Volljakë, Zabergjë, Përçevë.				**1** Refuzohet, **3** Adresohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi", në fshatin Zllakuqan, më banorët e fshatrave Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë e Madhe dhe Budisalc.	11.06.2025	**21** Pjesëmarrës.	**18** Burra, **3** Gra.	**2** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **2** Pranohen, **0** Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në Shtëpinë e Kulturës "Jehona e Dukagjinit", me temë "Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës".	11.06.2025	**2** Pjesëmarrës.	**0** Burra, **2** Gra.	**0** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.
Dëgjim Buxhetor në Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve.	12.06.2025	**40** Pjesëmarrës.	**36** Burra, **4** Gra.	**17** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **17** Pranohen, **0** Refuzohen.
Riorganizimi i Dëgjimit Buxhetor Shtëpinë e Kulturës "Jehona e Dukagjinit", me temë "Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës".	20.06.2025	**15** pjesëmarrës	**13** Gra, **2** Burra.	**10** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **8** Pranohen, **1** Refuzohet, **1** Adresohet.

Publikimi në ueb-faqe / platforma.	30 ditë	**0** pjesëmarrës	**0** Gra, **0** Burra.	**0** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara nga publikimi në ueb-faqe/platforma.
Kërkesa më email të personat e caktuar.	30 ditë	**2** pjesëmarrës	**1** Grua, **1** Burrë.	**4** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **4** Pranohen, **0** Refuzohen.
Kërkesa në formë fizike.	30 ditë	**0** pjesëmarrës	**0** Gra, **0** Burra.	**0** komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara nga publikimi në ueb-faqe/platforma.
Kërkesa në formë fizike nga OJQ dhe Grupe Specifike.	30 ditë	**43** pjesëmarrës	**23** Gra, **20** vajza, dhe **0** Burra.	**4** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **2** Pranohen, **1** Refuzohet, **1** Adresohet.
Gjithsej;	30 ditë 28.05.2025- 24.06.2025.	**255** pjesëmarrës	**47** Gra, **20** vajza, dhe **188** Burra.	**136** kërkesa apo sugjerime të regjistruara; **122** Pranohen, **6** Refuzohen, **8** Adresohen.

VLERËSIMI I GRUPIT PUNUES MBI KËRKESAT E QYTETARËVE

Grupi punës ka grumbulluar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe të njëjtat pasi i ka vendosur në dokumentin punues i ka analizuar dhe komfor standardeve të përcaktuara më lartë ka vendosur për pranimin, pranime të pjesshëm, refuzimin dhe adresimin e kërkesave. Vendimet e anëtarëve të grupit janë pasqyruar në tabelën /shtojcën nr. 5 bashkë me arsyetimet e grupit.

Shtojca nr. 5 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuara dhe të refuzuara:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	**Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.**	**Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimit të komenteve është i detyrueshëm).**
DËGJIMI BUXHETOR NË SALLËN E KONFERENCAVE, NË KOMUNËN E KLINËS, ME KRYETARËT E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE.		
Elvis Përlleshi, Kryetar i Këshillit Lokal në Jagod; Kërkesë më prioritet për fshatin Videjë është ri-asfaltimi i rrugës kryesore "Kolë Gojani" në fshatin Videjë, e cila lidh 7 fshatra me qytetin e Klinës, e cila është e gjatë 1700 metra. Ri-asfaltimin e plotë te kësaj rruge, ndërtimi i trotuarit përgjatë saj dhe trupat ndriçues.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe", në vlerën totale prej 40,000.00 €, në vitin 2026, 30,000.00€, në vitin 2027, si dhe 50,000.00€, në vitin 2028.
Elvis Përlleshi, Kryetar i Këshillit Lokal në Jagod; Kërkesë më prioritet për fshatin Videjë është edhe ndërtimi i kanalit të ujitjes për tokat bujqësore në fshatrat Krushevë e Madhe,	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Jagodë dhe Videjë, ku janë rreth 100 hektar.		Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i kanaleve te ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë-Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj", në vlerën totale prej 130,000.00 €, në vitin 2026, 120,000.00€, në vitin 2027, si dhe 120,000.00€, në vitin 2028.
Faruk Smajli, Kryetar i Këshillit Lokal në Poterç të Epërm; Kërkesë më prioritet në fshatin Drenoc është ndërtimin e një parku të lapidari i dëshmoreve.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, tek drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, kodi "Zgjerim i sipërfaqeve të gjelbëruara".
Faruk Smajli, Kryetar i Këshillit Lokal në Poterç të Epërm; Kërkesë më prioritet në fshatin Drenoc është edhe ri-asfaltimi në disa vende, rrugë të dëmtuara me kontratën e mirëmbajtës me asfalt.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë tę komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterç-Dugajevë-Drenoc", në vlerën totale prej 60,000.00 €, në vitin 2026, 40,000.00€, në vitin 2027, si dhe 60,000.00€, në vitin 2028.
Faruk Smajli, Kryetar i Këshillit Lokal në Poterç të Epërm; Kërkesë më prioritet në fshatin Dugajevë është asfaltimi i disa rrugicave me gjatësi afër 200 metra.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

		Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterç-Dugajevë-Drenoc", në vlerën totale prej 60,000.00 €, në vitin 2026, 40,000.00€, në vitin 2027, si dhe 60,000.00€, në vitin 2028.
Faruk Smajli, Kryetar i Këshillit Lokal në Poterç të Epërm; Kërkesë më prioritet në fshatin Dugajevë është edhe hapja e disa rrjedhave ujore me makineri, pasi që sezonin e dimrit po rrezikojnë vërshime se janë mbyllur.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës. Grupi punues ka konstatuar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për një projekt investiv por për një shërbim që mund të ofrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim më drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
Faruk Smajli, Kryetar i Këshillit Lokal në Poterç të Epërm; Kërkesë më prioritet në fshatin Poterç i Poshtëm është asfaltimi i rrugës për të varrezat si dhe dy rrugica të "Ilir Daka" dhe "Mahir Magjuni".	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterç-Dugajevë-Drenoc", në vlerën totale prej 60,000.00 €, në vitin 2026, 40,000.00€, në vitin 2027, si dhe 60,000.00€, në vitin 2028.
Faruk Smajli, Kryetar i Këshillit Lokal në Poterç të Epërm; Kërkesë më prioritet në fshatin Poterç i Epërm është zhvendosja e ndriçimit me shtylla nga rruga "Lumbardhi" në rrugën në breg.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës. Grupi punues ka konstatuar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për një projekt investiv por për një shërbim që mund të ofrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Faruk Smajli, Kryetar i Këshillit Lokal në Poterç të Epërm; Kërkesë më prioritet në fshatin Dugajevë edhe rregullimi i shtratit të lumit ku po i dëmton tokat në Dugajevë, të Arben Krasniqi.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bardhë", në vlerën totale prej 50,000.00 €, në vitin 2026, 50,000.00€, në vitin 2027, si dhe 200,000.00€, në vitin 2028.
Simon Përlaska, Kryetar i Këshillit Lokal në Zllakuqan; Kërkesë më prioritet në fshatin Leskoc është kyçja në kanalizim e lagjeve që gjendën në rrugën "Shën Gjoni", "Çajupi", si dhe pjesa të shkolla.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës. Grupi punues ka konstatuar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për një projekt investiv por për një shërbim që mund të ofrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Simon Përlaska, Kryetar i Këshillit Lokal në Zllakuqan; Kërkesë më prioritet në fshatin Leskoc është edhe asfaltimi i rrugicave në lagjen "Rrapi".	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc", në vlerën totale prej 20,000.00 €, në vitin 2026, 30,000:00€, në vitin 2027, si dhe 70,000.00€, në vitin 2028.

Binak Gashi, Kryetar i Këshillit Lokal në Gremnik; Kërkesë më prioritet në fshatin Gremnik është ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lokacionin Hekurudha-Gremnik.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë nuk do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, pasi ky projekt është në listën e Planifikimit të Prokurimit Publik për vitin fiskal 2025, ku pritet të implementohet brenda këtij viti, shumë shpejtë edhe në procedurë iniciuesi më titullin "Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gremnik – Qupevë e Ulët".
Binak Gashi, Kryetar i Këshillit Lokal në Gremnik; Kërkesë më prioritet në fshatin Gremnik është rregullimi i ujësjellësit në Gremnik-Dollc.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës. Grupi punues ka konstatuar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për një projekt investiv por për një shërbim që mund të ofrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim më Kompaninë Regjionale të Ujësjellësit "Hidrodrini".
Binak Gashi, Kryetar i Këshillit Lokal në Gremnik; Kërkesë më prioritet në fshatin Gremnik është edhe rregullimi i rrethojave të varrezave të fshatrave Gremnik-Dollc.	**Pranohet**	**Përgjigja:** Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2026, 2027 dhe 2028, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, kodi buxhetor më titull "Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, Krushevë e Vogël, Shtupel etj", në vlerën totale prej 130,000.00 €, në vitin 2026, 80,000.00€, në vitin 2027, si dhe 100,000.00€, në vitin 2028.
Shaqir Elezaj, Kryetar i Këshillit Lokal në	**Pranohet**	**Përgjigja:**

